

# Statistikat afatshkurtra

## Prodhuesit e të mirave - Tremujori II 2023


**Tiranë, më 15 Shtator 2023:** Treguesit tremujorë mbi prodhuesit e të mirave, përfshijnë aktivitetet ekonomike: Industri (Industri Nxjerrëse dhe Industri Përpunuese); Energji elektrike, Gaz, Avull; Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve; Ndërtim, në tremujorin e dytë 2023, paraqiten si më poshtë:

### Industria:

Indekset e treguesve në aktivitetin Industri, në tremujorin e dytë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi ulje 9,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi ulje 13,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi ulje 1,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 13,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Industri (%)




**Energji elektrike, Gaz, Avull:**

Indekset e treguesve në aktivitetin Energji elektrike, Gaz, Avull, në tremujorin e dytë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 17,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 8,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 16,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Fig. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të prodhimit në volum, Energji elektrike, Gaz, Avull (%)**



**Furnizimi me ujë, Trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve:**

Indekset e treguesve në aktivitetin Furnizimi me ujë dhe Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve, në tremujorin e dytë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi ulje 16,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi ulje 4,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 2,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 19,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Fig. 3 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto në volum, Furnizimin me ujë, Trajtimi e menaxhimi i mbetjeve (%)**




**Ndërtimi:**

Indekset e treguesve në aktivitetin Ndërtim, në tremujorin e dytë 2023, paraqiten si më poshtë:

- Indeksi i shitjeve neto në volum shënoi rritje 5,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i prodhimit në volum shënoi rritje 6,5 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i numrit të të punësuarve shënoi rritje 2,6 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- Indeksi i fondit të pagave shënoi rritje 17,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

**Fig. 4 Ndryshimet vjetore të Indeksit të shitjeve neto, Ndërtim (%)**



**Tab. 1 Indeksi i shitjeve neto në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.II 2023 (2015=100)	II.23 / II.22 (%)	Tr.II 2023 (2015=100)	II.23 / I.23 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	122,7	-9,0	127,3	2,5
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	66,2	-25,2	66,3	5,3
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	149,3	-5,3	158,6	4,2
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	...	...	...	...
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	127,4	-16,9	126,6	-2,8
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	166,4	5,2	173,4	1,3
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	154,9	-9,3	159,6	1,9
		Energji	...	...	...	...
		Mallra kapitale	162,5	-10,3	175,1	-6,6
		Mallra të qëndrueshme konsumi	123,8	-14,9	132,3	3,4
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	120,5	-6,5	121,5	1,1

... Në proces rishikimi metodologjia për Indeksin e shitjeve neto në volum, për aktivitetin Energji elektrike, Gaz, Avull

**Tab. 2 Indeksi i prodhimit në volum, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Pa përshtatje sezonale		Me përshtatje sezonale	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.II 2023 (2015=100)	II.23 / II.22 (%)	Tr.II 2023 (2015=100)	II.23 / I.23 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	105,7	-13,5	109,8	3,3
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	63,9	-29,4	66,2	1,1
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	132,9	-8,4	137,9	2,6
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	94,5	17,2	88,9	-0,6
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	133,5	-4,1	135,2	0,1
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	178,3	6,5	186,2	1,9
<b>Grupimet industriale kryesore</b>						
		Mallra të ndërmjetme	126,6	-17,6	130,4	1,6
		Energji	80,1	7,4	78,7	-1,9
		Mallra kapitale	185,0	-7,6	197,5	-3,6
		Mallra të qëndrueshme konsumi	125,7	-13,5	133,9	5,1
		Mallra të paqëndrueshme konsumi	115,3	-9,4	117,8	3,5

**Tab. 3 Indeksi i numrit të të punësuarve dhe fondit të pagave, prodhuesit e të mirave**

NVE Rev.2			Numri i të të punësuarve		Fondi i pagave	
Seksioni	Ndarja	Aktiviteti ekonomik	Tr.II 2023 (2015=100)	II.23 / II.22 (%)	Tr.II 2023 (2015=100)	II.23 / II.22 (%)
B-C	05-33	<b>Industri</b>	105,3	-1,7	173,6	13,2
B	05-09	<i>Industri nxjerrëse</i>	74,5	-2,8	118,0	8,2
C	10-33	<i>Industri përpunuese</i>	109,8	-1,6	193,2	14,2
D	35	Energji elektrike, Gaz, Avull	126,2	8,1	227,6	16,4
E	36-39	Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë	121,9	2,9	188,6	19,1
F	41-43	<b>Ndërtim</b>	129,5	2,6	189,1	17,8

# Metodologjia

## Informacion

Në vazhdim të përpjekjeve të përafërimit dhe standardizimit të statistikave afatshkurtra me statistikat evropiane, INSTAT publikon Statistikat Afatshkurtra –Të mira si më poshtë :

- Indekset duke filluar nga tremujori i parë 2019, do të llogariten me vit bazë 2015=100.
- Peshat janë llogaritur bazuar në rezultatet e Anketës Strukturore e Ndërmarrjeve për vitin 2020, realizuar nga INSTAT.

## Informacion mbi vrojtimin

**Qëllimi** - Statistikat afatshkurtra paraqesin ecurinë e ekonomisë së vendit në periudha tremujore, nëpërmjet të cilave kuptohet zhvillimi i ciklit të ekonomisë si dhe mund të bëhen parashikime për të ardhmen e afërt. Vrojtimi tremujor ka për qëllim të paraqesë ecurinë e treguesve kryesorë ekonomikë të ndërmarrjeve ekonomike në periudha tremujore.

### Në prodhuesit e të mirave:

**Fusha e mbulimit** - Bazuar në aktivitetin kryesor, në anketën tremujore pranë ndërmarrjeve janë përfshirë ndërmarrjet që kryejnë këto aktivitete:

- Industri, e cila përbëhet nga Industria Nxjerrëse dhe Përpunuese (05 – 33)
- Energji elektrike, gaz, avull (35)
- Furnizimi me ujë, trajtimi dhe menaxhimi i mbetjeve (36-39)
- Ndërtim (41, 42, 43)

**Modeli** - Kampioni i ndërmarrjeve është zgjedhur nga Regjistri Statistikor i Ndërmarrjeve, ku kampioni për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë me zgjedhje, ndërsa ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht.

**Mbledhja e informacionit** - Për këtë tremujor janë përdorur burimet administrative dhe intervistim të drejtpërdrejtë nga anketuesit, të cilët plotësojnë anketën tremujore në bazë të deklarimeve që bën personi përgjegjës i ndërmarrjes për plotësimin e kësaj ankete.

**Treguesit** - Janë dhënë në formë indeksi, ndryshimi vjetor në përqindje, ndryshimi tremujor në përqindje me vit referues bazë, aktualisht 2015=100. Të dhënat nuk paraqesin vlera absolute.

**Indekset** - Shprehin ndryshimin në kohë të një variabli të dhënë ose tërësi variablash. Indeksi i volumit është llogaritur me anë të formulës Laspeyres. Për të eliminuar ndikimin e çmimeve, indekset deflatohen me indekset përkatëse të çmimeve, si: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit për aktivitetin industrial dhe Tregtinë me Shumicë, Indeksi i Kostos në Ndërtim për aktivitetin ndërtimor.

**Ndryshimi vjetor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit të njëjtë të një viti më parë.

**Ndryshimi tremujor në përqindje** - Mat ndryshimin në përqindje të treguesit ekonomik të tremujorit aktual ndaj tremujorit paraardhës të të njëjtit vit.

**Rishikimi** – Indekset mund të rishikohen për disa arsye: Informacion shtesë, ndryshime metodologjike ose rivlersime të koeficientëve të përdorur, etj.

**Përkufizimet e treguesve kryesorë**

*Shitjet neto* - *Shitjet neto* përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësia që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korespondon me tregun e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar.

*Indeksi i shitjeve neto* - Objektivi i indeksit të *shitjeve neto* është të paraqesë ecurinë e tregut për mallra dhe shërbime.

*Numri i të punësuarve me pagesë* - Numri gjithsej i personave të punësuar me pagesë në njësinë e vrojtuar (përfshirë të vetëpunësuarit me pagesë).

*Paga dhe trajtime* - Ajo përfshin fondin e pagave dhe shpërblimet e trajtimit (në vlerë monetare apo natyrë - të vlerësuar në lekë) paguar të gjithë të punësuarve, në këmbim të punës së kryer gjatë periudhës referuese.

*Indeksi i fondit të pagave* - Indeksi i fondit të pagës paraqet në mënyrë të përafërt ecurinë e fondit të pagave, në njësinë e vrojtuar, nga njëra periudhë në tjetrën.

**Grupimet Industriale Kryesore** janë një rigrupim i aktiviteteve Industri Nxjerrëse, Industri Përpunuese dhe Energji të detajuara sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE Rev.2), si më poshtë:

Grupimet Industriale Kryesore	NVE Rev.2
Mallra të ndërmjetme	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 07-09 Nxjerrja e mineraleve natyrore; Nxjerrja e mineraleve të tjera nga minierat; Aktivitete mbështetëse minerare</li> <li>• 13000 Përpunimi i tekstileve</li> <li>• 16000 Prodhimi i drurit dhe materialeve prej druri, përveç mobiljeve</li> <li>• 17000 Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letre</li> <li>• 20-21 Prodhimi i kimikateve dhe produkteve kimike; Përpunimi i produkteve farmaceutike</li> <li>• 22000 Prodhimi i produkteve të kauçikut dhe plastikës</li> <li>• 23000 Prodhimi i produkteve minerale jo metalike</li> <li>• 24000 Metalurgjia</li> <li>• 255XX Farkëtimi, stampimi, petëzimi dhe trafilizimi i metaleve</li> <li>• 27000 Prodhimi i pajisjeve elektrike</li> </ul>
Energji	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 05-06 Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve; Nxjerrja e naftës bruto dhe gazit natyror</li> <li>• 19000 Përpunimi i koksit dhe rafineria e nënprodukteve të naftës</li> <li>• 35000 Energjia elektrike, gazi, avulli dhe ajri i kondicionuar</li> </ul>
Mallra kapitale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 251XX Prodhimi i produkteve metalike strukturore</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 262XX Prodhimi i kompjuterave dhe pajisjeve periferike</li> <li>• 28000 Prodhimi i makinerive dhe pajisjeve p.k.t</li> <li>• 33000 Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve</li> </ul>
Mallra të qëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 264XX Prodhimi i produkteve elektronike për konsumatorët</li> <li>• 31000 Prodhimi i mobiljeve</li> <li>• 32XXX Industri të tjera p.k.t</li> </ul>
Mallra të paqëndrueshme konsumi	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 10000 Përpunimi i produkteve ushqimore</li> <li>• 11-12 Prodhimi i pijeve; Prodhimi i produkteve të duhanit</li> <li>• 14000 Konfeksionimi i veshjeve</li> <li>• 15000 Prodhimi i lëkures dhe produkteve prej lëkure</li> <li>• 18000 Shtypshkrimi dhe rigrupimi i mediave të regjistruara</li> <li>• 32YYY Industri të tjera p.k.t</li> </ul>

### Përshtatja sezonale

Përshtatja sezonale në seritë tremujore të prodhimit të të mirave materiale u zbatua duke përdorur si software JDemetra+, versioni 2.2.0. Model i përzgjedhur për shpërbërjen e serive është X-12 Arima, nënspecifikimin X-13 në serinë kohore Tremujori I 2006 - Tremujori III 2022. Modeli X-12 Arima bazohet plotësisht mbi mesataren e lëvizëshme. Në seritë e të dhënave është zbatuar shpërbërja e shumëfishtë (multiplikative). Në metodën multiplikative ekziston një lidhje midis komponentit të trendit, komponentit sezonal dhe komponentit irregular, ku ky i fundit shpjegon ato pjesë të serisë kohore të cilat nuk mund të parashikohen dhe janë të pazakonshme. Përshtatjet janë në drejtim të ndikimeve sezonale në pasqyrimin e statistikave afatshkurtra. Për përshtatjet sezonale të serive është përdorur qasja direkte. Në përshtatjen sezonale janë analizuar edhe ngjarjet e veçanta të ndodhura përgjatë harkut kohor të shtrirjes së serive.